



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në pajtim me nenin 39, paragrafi 1,7 dhe 8 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtaret Publik në Nenin 99 të Ligjit Nr.0/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Neni 7 të Rregullores (QEK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, në vijim të procedurës së verifikimit paraprak të aplikacioneve për konkurset me numrat e referencave RN00015367 të shpallur me datën e njoftimit 04.10.2024 dhe afati për aplikim nga data 05.10.2024 deri me 03.11.2024, nxjerr:

V E N D I M

1. Për shkak të kompleksitetit të çështjes administrative, shtyhet afati për përfundimin e procedurës së verifikimit të aplikacioneve për konkurset me Nr.Ref. RN00015367 edhe për 15 ditë të tjera pas përfundimit të afatit fillestar për përfundimin e kësaj procedure.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
3. Vendimi publikohet në SIMBNJ dhe në web faqe të Ministrisë.

Arsyetim

Duke marr parasysh numrin e madh të aplikacioneve të pranuar për konkursin me Nr.Ref. RN00015367, të shpallur me datën e njoftimit 04.10.2024 dhe afati për aplikim nga data 05.10.2024 deri me 03.11.2024 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për shkak të kompleksitetit të çështjes administrative konkrete, gjegjësisht vëllimit të madh të aplikacioneve, si dhe mos aplikimit të profesorëve të fushës së njëjtë për

procedurën për të cilën zhvillohet konkurrimi, sipas shpalljes publike të datës 22.10.2024, në pamundësi të procesit të verifikimit brenda afatit fillestar, në pajtim me dispozitat e lartëcekura u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi publikohet në:

- SIMBNJ
- Faqen zyrtare të MMPHI

Have Krasniqi

Udhëheqëse e DBNJ

